


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT-GJILAN

Në bazë të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komuna, neneve 7, 9, 44 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Statutit të Komunës së Gjiçanit, 01. nr. 016-126211, të datës 06.11.2014, Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit nxjerr:

VENDIM

Neni 1

Me këtë vendim anulohet procedura e shqyrtimit të kërkesave të brendshme dhe të jashtme për transferimin e mësimdhënësve të paraqitura në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjiçan për vitin shkollor 2026/2027.

Neni 2

Obligohet Zyra për Punë dhe Personel në Drejtorinë Komunale të Arsimit që t'i njoftojë me këtë vendim të gjithë mësimdhënësit që kanë paraqitur kërkesë për transferim.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Drejtorja Komunale e Arsimit në Gjiçan, pas shqyrtimit të rrethanave dhe nevojave aktuale të institucioneve arsimore, ka vendosur për anulimin e konkursit për transferimin e stafit.

Anulimi bëhet edhe për arsye që plotësimi i vendeve të punës të bëhet përmes konkursit të hapur dhe publik duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë kandidatet e interesuar që i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pozitat e lira të punës.

Për këto arsye anulohet konkursi dhe pas përfundimit të analizës së nevojave reale për personel, procedurat e rekrutimit ose transferit do të zhvillohen siq u tha më lartë konform konkursit të hapur dhe publik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Të gjithë mësimdhënësve të cilët kanë paraqitur kërkesa;
- Zyrës për Punë dhe Personel në DKA;
- Arkivit të DKA-së.

